



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA Durrës
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

Durrës, më 22.07.2025

PROCESVERBAL
Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“FV orendi pajisje për çerdhe”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Mobilime të ndryshme -39290000-1.

VLERA E FONDIT LIMIT:

1,889,875 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) Lek pa TVSH.

Argumentim:

MBI PËRGATITJEN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PËRLLOGARITJEN E VLERËS
LIMIT TË KONTRATËS

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve nr.120 e nr.6148 prot., datë 21.05.2025 të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Durrës, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Specifikimeve Teknike si dhe Përllogaritjen e Fondit Limit, për procedurën e prokurimit me objekt: “FV orendi pajisje për çerdhe”.

Grupi i specifikimeve teknike, pasi u njoh me objektin e prokurimit:

1. Dokumenteve sipas buxhetit të Bashkisë Durrës të vitit 2025-2027 të miratuara nga Këshilli Bashkiak, për fondin limit.
2. Shqytroi dokumentat e mësipërme dhe programoi punën për grumbullimin e informacionit, lidhur me projektin, preventivin dhe specifikimet teknike të hartuara nga grupi i specifikimeve teknike.

I. PERCAKTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE;

Në hartimin e specifikimeve teknike, grupi i punës u mbështet në informacionin e mbledhur nga burimet e mëposhtme:

- a. Dokumentacioni dhe materialet e blerjeve të mëparshme;
- b. Çmimet e publikuara nga INSTAT për kategori të ngjashme mallrash;
- c. Tre oferta të marra nga subjekte të ndryshme tregtare në kuadër të hetimit të tregut.

Grupi i punës organizoi punën për mbledhjen dhe analizimin e informacionit mbi specifikimet teknike për mallrat objekt i kësaj procedure, duke ndjekur këto hapa:

- Ju dërgua shkresë zyrtare drejtuar Operatorit të Blerjeve të Përqendruara (OBP), me nr. 6148/2 prot., datë 29.05.2025, me lëndë: “Kërkesë për informacion mbi specifikimet teknike dhe çmimet referencë zyrtare për prokurim publik”. Ky operator nuk ktheu përgjigje për informacionin e kërkuar.
- Ju dërgua shkresë zyrtare drejtuar INSTAT, me nr. 6378 prot., datë 28.05.2025 me lëndë: “Kërkesë për informacion mbi çmimt referencë zyrtare për prokurim publik”. Ky operator iu përgjigj kërkesës tone me shkresën nr. 1064/1 prot., datë 09.06.2025, në të cilën u shpreh se nuk disponon informacionin e kërkuar nga ana jonë.
- Ju dërgua shkresë zyrtare drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve, Sektorit të Prokurimeve me nr. 6148/1 prot., datë 29.05.2025 me lëndë: “Kërkesë për informacion mbi kontrata të ngjashme për prokurim publik”. Kjo drejtori iu përgjigj kërkesës tonë me shkresën nr. 6148/3 prot., datë 30.05.2025, në të cilën u shpreh se nuk ka realizuar asnjë procedurë që të kenë si objekt blerje këto artikuj.

Pas verifikimit të burimeve ekzistuese dhe në mungesë të specifikimeve të standardizuara, komisioni hartoi specifikimet teknike në përputhje me natyrën dhe funksionalitetin e mallrave të kërkuara, duke u bazuar në praktikën më të mirë.

Specifikimet teknike u unifikuan dhe standardizuan nga grupi i punës me qëllim garantimin qartësisë dhe objektivitetit në procesin e prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Specifikimet Teknike të përcaktuara në këto dokumente janë në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit nr.162 datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

II. PËRLLOGARITJA E VLERES LIMIT TË KONTRATËS

Për përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar me Ligjin nr.16/2024 Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, u bazua në burime të njohura dhe të pranueshme ligjërish, duke përfshirë:

- Çmimet e publikuara nga INSTAT dhe/ose burime të tjera zyrtare si: organet tatimore, doganore, Dhomat e Tregtisë apo manuale tregtare;
- Çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete kontraktore;
- Çmime aktuale të tregut vendas apo ndërkombëtar.

Grupi i punës organizoi punën për mbledhjen dhe analizimin e informacionit mbi çmimet orientuese për mallrat objekt i kësaj procedure, duke ndjekur këto hapa:

- Ju dërgua shkresë zyrtare drejtuar Operatorit të Blerjeve të Përqendruara (OBP), me nr. 6148/2 prot., datë 29.05.2025, me lëndë “Kërkesë për informacion mbi specifikimet teknike dhe çmimet referencë zyrtare për prokurim publik”. Ky operator nuk ktheu përgjigje për informacionin e kërkuar.
- Ju dërgua shkresë zyrtare drejtuar INSTAT, me nr. 6378 prot., datë 28.05.2025 me lëndë “Kërkesë për informacion mbi çmimet referencë zyrtare për prokurim publik”. Ky operator iu përgjigj kërkesës tone me shkresën nr. 1064/1 prot., datë 09.06.2025, në të cilën u shpreh se nuk disponon informacionin e kërkuar nga ana jonë.
- Ju dërgua shkresë zyrtare drejtuar Drejtorisë së Shërbimeve, Sektorit të Prokurimeve me nr. 6148/1 prot., datë 29.05.2025 me lëndë “ Kërkesë për informacion mbi kontrata të ngjashme për prokurim publik”. Kjo drejtori iu përgjigj kërkesës tonë me shkresën nr. 6148/3 prot., datë 30.05.2025, në të cilën u shpreh se nuk ka realizuar asnjë procedurë që të kenë si objekt blerje të këtyre artikujve.

Për mallrat për të cilat mungojnë të dhënat zyrtare, u morën në konsideratë çmimet e ofruara nga subjektet që paraqitën ofertat në kuadër të hetimit të tregut, respektivisht 3 subjekte.

Në përgjigje të kërkesës së dërguar, shoqëritë depozituan ofertat e tyre ekonomike, të cilat janë administruar në dosje. Komisioni i vlerësoi këto dokumente si të dobishme dhe vendosi t’i marrë në konsideratë në kuadër të përlllogaritjes së vlerës orientuese të kontratës.

Në përfundim, pas shqyrtimit të informacionit të mbledhur, rezultoi se:

- Nuk ka kontrata të mëparshme të ngjashme për këtë kategori prokurimi;
- Nuk ka të dhëna të disponueshme nga INSTAT për çmimet e mallrave objekt të kësaj procedure;
- Grupi i punës kreu një studim të tregut, duke marrë në shqyrtim tre oferta të depozituara nga subjekte të ndryshme tregtare, dhe bazuar në metodologjinë e ndjekur, përlllogariti çmimin mesatar të tyre si vlerë orientuese për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës.

Pas shqyrtimit të të dhënave dhe informacionit të mbledhur, mbështetur në rezultatin e sipërnxjerrë, rezultoi se: Vlera e përgjithshme e kontratës rezulton të jetë: 1,889,875 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) Lek pa TVSH.

Afatet e lëvrimit: 45 (dyzet e pesë) ditë kalendarike, nga dita e nënshkrimit të kontratës.

Garancia e mallit do të jetë sipas specifikimeve teknike, bashkëngjitur.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Durrës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

III. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklarimit të xhiros vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (2022, 2023,

2024)), lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare, konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur në mbështetje të nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43 pika 3, nenit 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se vlera e fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 40 pika 3 ku përcaktohet se: “ Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës” dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave” duke qënë se vlera e fondit limit të objektit përkatës është nën kufirin e ulët monetar kriteri hartohet në përputhje me vlerën procedurës.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit objektin është nën kufirin e ulët monetar që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapu e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 55 pika 4 e VKM Nr.285, dt.19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një dokument që vërteton se (subjekti i tij) i ka plotësuar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2025, referuar ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, si dhe sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak përkatës ku subjekti ushtron aktivitetin, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 në DST, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP-së i ndryshuar, si dhe të Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Shlyerja e detyrimeve vendore për vitin 2025 ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendndodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të kontratës. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 germa b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar fondit limit sipas nenit 55 pika 4, germa b, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për

kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë staf teknik të punësuar gjatë gjashtë (6) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave, për të cilët janë kryer pagesat përkatëse të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Stafi minimal i kërkuar për realizimin e kësaj kontrate duhet të përfshijë:

- a. 1 (një) drejtues mjeti, për transportin dhe dorëzimin e materialeve;
- b. 2 (dy) ndihmës punëtorë, për ngarkim-shkarkimin dhe mbështetjen në vendosjen e pajisjeve dhe orendive;
- c. 1 (një) punëtor montimi
- d. 2 (dy) marangoz (në rast se është prodhues mobiljesh)

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet për specialistin teknik të montimit:

Diplomë teknike ose certifikatë profesionale:

- Diplomë nga shkolla profesionale/teknike në fushat: elektroteknikë, frigoriferikë, instalime elektrike, pajisje elektro-shtëpiake industriale etj.
- Ose certifikatë trajnimi nga institucione të licencuara, që mbulon montimin e pajisjeve të ngjashme me ato të prokurimit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentim teknik: Kërkesa për staf minimal synon të garantojë transportin, dorëzimin dhe montimin korrekt të pajisjeve. Drejtuesi i mjetit siguron lëvizjen e sigurt të pajisjeve; ndihmës punëtorët janë të nevojshëm për ngarkim-shkarkim dhe vendosje në terren; ndërsa puntor montimi është i domosdoshëm për montimin e pajisjeve dhe orendive në ambientin e çerdhes. Marangozët janë të domosdoshëm kur Operatori është prodhues mobiljesh.

Argumentimi ligjor: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Kreut V, Seksioni III, nenit 40 pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.3 Operatori merr përsipër montimin dhe vendosjen në punë të gjitha pajisjeve.

Argumentim: Ky kriter siguron që pajisjet të jenë jo vetëm të dorëzuara, por edhe të instaluar dhe funksionale, duke shmangur vonesa dhe probleme teknike. Operatorit i kërkohet përgjegjësi e plotë për vënien në punë të tyre.

2.3.4 Manual teknik në gjuhën shqipe

Argumentim: Manuali në shqip siguron përdorim të saktë dhe mirëmbajtje të sigurtë të pajisjeve nga stafi i njësisë përfutuese, duke shmangur keqkuptimet dhe rreziqet në përdorim.

2.3.5 Pajisjet të jenë të reja në kuti

Argumentim: Kërkesa siguron që pajisjet të jenë të papërdorura, në gjendje optimale teknike dhe me jetëgjatësi maksimale, duke garantuar cilësi dhe funksionalitet të plotë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë 1(një) mjet transporti me peshë mbajtëse mbi 1.5 ton, të përshtatshëm për transport mallrash. Mjeti i transportit mund të jetë në pronësi ose me qira.

Mjeti në pronësi të shoqërohet me :

- Dokumenti që vërteton pronësinë (Akt i pronësisë)
- Leje qarkullimi
- Certifikatë e kontrollit teknik (i vlefshëm)
- Siguracion i mjetit(i vlefshëm)

Mjeti me qira të shoqërohen me :

- Kontratë përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të të jetë e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës si dhe aktin e pronësisë së qiradhënësit.
- Leje qarkullimi
- Certifikatë e kontrollit teknik (i vlefshëm).
- Siguracion i mjetit (i vlefshëm).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik: i ndryshuar, me ane të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion mjete dhe pajisje teknike për të përmbushur kontratën, të

nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Referuar specifikimeve teknike është përcaktuar se përveç furnizimit të mallit, objekt prokurimi, do të jete transporti dhe vendosja e tyre ne destinacionin përkatës (Çerdhja Manëzt). Është kërkuar mjet transporti me këtë kapacitet për të vërtetuar qe Ofertuesit pjesëmarrës kanë automjetin e nevojshëm për transportin e mallrave ne konviktet përkatëse, pasi objekti i kontratës është furnizim dhe vendosje.

2.3.7 Pajisjet të jenë të shoqëruar me garanci sipas specifikimeve teknike

Argumentim: Garancia siguron mbrojtje ndaj defekteve dhe detyron furnitorin të mbështesë funksionimin e pajisjes për periudhën e përcaktuar, duke garantuar cilësi dhe siguri për blerësin.

Këto kritere (pikat 2.3.3-2.3.7) do të quhen të përmbushura gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.4.1 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë:

- a. Certifikatë sipas standardit ndërkombëtar **ISO 9001** për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, ose një standard ekuivalent. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i cili është i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b. Certifikatë sipas standardit ndërkombëtar **ISO 14001** për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit, ose një standard ekuivalent. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmat përkatës të njohur në nivel kombëtar apo ndërkombëtar.
- c. Certifikatë sipas standardit ndërkombëtar **ISO 45001** për një Sistem të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (OHSMS Occupational Health and Safety Management System). Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i cili është i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet kur operatori ekonomik nuk i disponon vetë produktet e kërkuara, ai mund të ketë një kontratë apo marrëveshje bashkëpunimi me një subjekt tjetër i cili i zotëron këto produkte. Në këtë

rast, certifikatat ISO të kërkuara duhet të jenë të lëshuara në emër të subjektit bashkëpunëtor, me të cilin operatori ka lidhur kontratë apo marrëveshje bashkëpunimi. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të kontratës apo marrëveshjes përkatëse të notorizuar, së bashku me dokumentacionin që provon zotërimin e certifikatave ISO nga pala bashkëpunëtoare.

Ky kriter do të quhet i përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Nenit 44, pika 1 dhe 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.*

2.5 Kriter për shpalljen e ofertës fituese

Bazuar në pikën 3, neni 45, Seksioni III “Kërkesa të veçanta sipas tipeve të kontratave”, VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar:

*“..Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në **çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave...**”*

Ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin e parashikuar në pikën 6 të nenit 26 të VKM- së nr.285, datë 19.05.2021 i ndryshuar, brenda afatit 7 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas nenit 97/1 të LPP-së, i ndryshuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për s`kualifikim.

II Argumentimi i specifikimeve teknike

Bazuar në specifikimet teknike të hartuara nga struktura e posaçme e ngritur me urdhër të titullarit të autoritetit kontraktor konstatohet se plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 40 pika 2 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në këto kushte njëësia e prokurimit po publikon specifikimet teknike.

Specifikimet teknike dhe fondi limit i kontratës janë hartuar prej Autoritetit Kontraktor për nevojat e së cilës po kryhet kjo procedurë prokurimi.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përlogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT.

Dokumentet e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarët e njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit